



Datë: 24.11.2025

Numër Protokolli: 7547/2025

A.nr.1801/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar, *Ardita Haxhnikaj-Demi*, dhe Malsore Gashi-Bajraktari anëtar, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1801/2025 të datës 15.10.2025, të parashtruar nga ankuesja D.B, kundër organit të punësimit: Komuna e Klinës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2, dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 24.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1801/2025, e datës 15.10.2025, e parashtruar nga ankuesja D.B

II. Shfuqizohet Njoftimi me numër protokolli 111-34602/25 i datës 14.10.2025, lidhur me rezultatin përfundimtar, sipas Konkursit, me numër reference RN00018447, grupin I administrimit të përgjithshëm arsim i mesëm për pozitën “*Asistent për arkë*”

III. Mbetet në fuqi Konkursi me numër reference RN00018447, si dhe lista me numër 02 Nr.111-32716/25 e datës 26.09.2025 për verifikimin paraprak grupin i administrimit të përgjithshëm arsim i mesëm për pozitën “*Asistent për arkë*”, i shpallur nga Komuna e Klinës, ndërsa çështja kthehet në fazën e Themelimit të Komisionit Përzgjedhës.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, D.B(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), më datë 15.10.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6813/2025, të regjistruar nën shenjë A.nr.1801/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00018447, për pozitën e punës "Asistent për arkë", në Komunën e Klinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.10.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Klinës, ndërsa kjo e fundit, më datë 30.10.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto **prova:*** Ankesën me numër protokolli 6813/2025 të datës 15.10.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshill; Dokumentin e identifikimit të ankueses; Njoftimin me numër NR.111-34602/25 i datës 14.10.2025, për rezultatin përfundimtar të vlerësimit, të pozitës së punës "Asistent për arkë, në Komunën e Klinës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.10.2025; Përgjigjen në ankese me numër protokolli 1801/2025 te datës 30.10.2025; Renditjen përfundimtare të kandidatëve te datës 14.10.2025; Listën e datës 26.09.2025 lidhur me verifikimin paraprak; Konkursin me numër reference RN00018447 te datës 19.08.2025; Kërkesën me numër 02-111-27071/25 te datës 19.08.2025 për fillimin procedurës për rekrutimin në pranim së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Listën e aplikanteve; Emalin datës 28.10.2025; Emalin e datës 27.10.2025; Emalin e datës 28.10.2025; Emalin e datës 28.10.2025; Emalin e datës 14.10.2025; Formularët e vlerësimit të përgjithshëm të esesë; Vendimin me numër 01. NR.112/29835/25 te datës 02.09.2025 për themelimin e komisionit të vlerësimit; Akt emërimit me numër 01/39 të datës 10.06.2025 ; Akt emërimit e datës 17.12.2024; Vendimin me numër 111-30096/25 të datës 14.08.2025 për caktimin e ushtruesit të detyrës; Vendimin me numër 112/5069/25 të datës 19.02.2025 për caktimin e ushtruesit të detyrës; Akt emërimit me numër 112-2967/2025 te datës 02.09.2025; Akt emërimit me numër 02/10983/24 te datës 05.04.2024; Aplikacionin e datës 01.09.2025 të ankueses se bashku me dokumentacionin të cilat ka dorëzuar me rastin e aplikimit; Aplikacionin e datës 27.08.2025 të kandidatës fituese se bashku me dokumentacionin të cilat i ka dorëzuar me rastin e aplikimit.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses, **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se Komuna e Klinës, më datë 19.08.2025 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00018447, për pozitën e punës "*Asistent për Arkë*", me afat aplikimi nga data 20.08.2025 deri me datë 18.09.2025.

Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë njëmbëdhjetë (21) kandidatë, ku prej tyre tre (16) kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, duke përfshirë këtu edhe ankuesen D.B, e cila i është nënshtruar testimit me shkrim në të cilin ka arritur t'i mbledh 30.2 pikë, nga rrjedh se ankuesja nuk ka arritur t'i marrë pikët e mjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit atë të intervistës me gojë.

Divizioni i Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës, pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, gjegjësisht me datë 14.10.2025 ka publikuar Njoftimin me numër protokolli 111-34602/25, nga i cili njoftim rezulton se kandidatja A.E, me gjithsejtë 91.40 pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, është shpallur kandidate fituese për pozitën "*Zyrtar për Arkë*" 2.

Ankuesja, kundër njoftimit të lartë theksuar ka parashtruar ankesë në Këshill, mbi pretendimet ankimore se procedura e rekrutimit është zhvilluar në mënyre të anshme dhe jo transparente diskriminuese dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, duke kërkuar nga këshilli që të rishqyrtoj ligjshmërinë e procesit përzgjedhës për pozitën në fjalë, të verifikojë nëse ka pasur ndikime apo konflikt interesi në këtë proces të rekrutimi, si dhe ta shfuqizojë rezultatin përfundimtar duke u përsëritur procedura e rekrutimit në mënyre të drejtë.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: "*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*", lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e Konkursit me numër reference RN00018447, për pozitën e punës "*Asistent për arkë*" , Grupi i Administrimit të Përgjithshëm dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar: Diplomën e shkollës se mesme apo ekuivalente me të, Përvoja e punës nuk kërkohet**, andaj Kolegji i Këshillit, konstaton se kërkesat e përgjithshme formale të sapo theksuara janë vendosur në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht Shtojcës Nr.1/6 lidhur me përshkrimin e përgjithshëm të punës për klasën Profesional 3. Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore iu referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht:

- Nenit 39 paragrafi 1, është përcaktuar: 1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. Procedura e pranimi në Shërbimin Civil 1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përgjithësisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimi i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi, 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar prapë prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës.

-Neni 40 Komisioni i pranimi për pozita të kategorisë profesionale 1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimi. 2. Komisioni i pranimi ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/e civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues/e nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/e i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale. 3. Komisioni i pranimi zgjidhet ad hoc për çdo grup të administrimit të përgjithshëm apo të veçantë nga lista e kandidateve/ëve potencial. Lista e kandidateve/ëve potencial për anëtare/ë të komisionit miratohet nga Qeveria me propozim të ministres/it përgjegjës për administratë publike ndërsa për institucionin tjetër shtetëror nga titullarja/i i institucionit përkatës dhe ka vlefshmëri për dy (2) vite, me mundësi të ripërtëritjes sipas nevojës. 4. Komisioni i pranimi përzgjidhet përmes sistemit kompjuterik në mënyrë algoritmike nga njësia përgjegjëse, e cila emëron komisionin e pranimi.

Kolegji mori për bazë edhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me theks të veçantë: *Neni 20 Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë profesionale 1. Komisioni i pranimit për vlerësimin profesional të kandidateve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale themelohet me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ të institucionit që zhvillon procedurën e rekrutimit për institucionet e administratës shtetërore. Komisioni i pranimit në institucionin tjetër themelohet me vendim të titullarit të institucionit. 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues nga NjMBNj; dhe 2.3. një (1) nëpunës i kategorisë profesionale i fushës përkatëse. 3. Për secilin nga kategoritë e anëtarëve të Komisionit, caktohet një anëtar zëvendësues. Anëtari zëvendësues ushtron detyrën në rastin e pamundësisë të përkohshme të anëtarit kryesor. 4. Në procedurë rekrutimi për pozita të kategorisë profesionale në cilësinë e vëzhguesve mund të marrin pjesë përfaqësues nga shoqëria civile dhe sindikatat.*

Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas Vendimit 112-29835/25 të datës 02.09.2025, të Kryetarit të Komunës së Klinës, është themeluar Komisioni i Pranimit për vlerësimin profesional për pozitën “Asistent për arkë”: me përbërje nga 1. A.B, kryetar-A.G, zëvendësues, 2. A.K, anëtar-Xh.D, zëvendësues, 3. A.Z, anëtare-M.G, zëvendësues, 4. R.G, anëtar-H.M, zëvendësues dhe 5. R.S, anëtare-L.M, zëvendësuese, rrjedhimisht me qëllim të shqyrtimit të drejtë të ankesës me numër protokolli 6813/2025 të datës 15.10.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshill, dhe mbi bazë të shqyrtimit të të gjitha provave materiale, Kolegji ka konstatuar se pjesë e Komisionit të Pranimit nga kategoria e Njesisë së Burimeve Njerëzore nuk ka qene asnjë nga zyrtaret e institucionit respektivisht të Komunës së Klinës ashtu siç e përcakton Neni 16 paragrafi 1, 2, dhe 3 te Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore 1. Çdo institucion që punëson zyrtarë/ë publik në fushën e veprimit të këtij ligji, duhet të ketë Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive. 2. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka këto kompetenca: 2.1. ofron mbështetje për nëpunësen/in më të lartë administrativ dhe/apo për titullaren/in e institucionit në fushën e burimeve njerëzore; 2.2. përgatit planin vjetor të personelit, në përputhje me procesin e planifikimit buxhetor të institucionit; 2.3. ofron ndihmë për njësitë përkatëse në përgatitjen e përshkrimeve, klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës; 2.4. identifikon dhe vlerëson, në koordinim me udhëheqësen/in e njësisë në mënyrë periodike, nevojat për trajnim të nëpunësve/ëve civil të institucionit për aftësimin dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve për zhvillimit profesional; 2.5. menaxhon proceset e ndërlydhura me emërimin, përfundimin e marrëdhënies së punës, transferimit, suspendimit, pensionimit dhe çdo proces tjetër që ndërlydhet me punësimin e zyrtareve/ëve publik; 2.6. mbështet procedurën për vlerësimin e performancës, rekomandon transferimin e nëpunës/it civil, si dhe menaxhon paraqitjen në punë të zyrtares/it publik; 2.7. administron planet dhe dosjet individuale përmes SIMBNj-së; 2.8. kryen çdo detyrë tjetër të dhënë me ligj.

3. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në nivelin komunal, i zhvillon procedurat për pranimin në punë për zyrtaret/ët publik në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, ndërsa në bazë të shkresave të lëndës respektivisht sipas aktit të emërimit me numër 1-180/4303 të datës 10.06.2025, anëtar i komisionit nga Njësia e Burimeve Njerëzore në këtë procese të rekrutimit është Menaxheri i Personelit në Komunën e Junikut, për deri sa Komuna e Klinës ka edhe Menaxherin e Personelit dhe Zyrtarin e Personelit vendimi me numër 112-29835/25 i datës 02.09.2025 i kryetarit të Komunës së Klinës është themeluar në kundërshtim me dispozitat si me lartë.

Rrjedhimisht, duke u bazuar në konstatimet si më sipër, dhe nga administrimi i provave të lëndës Kolegji i Këshillit, konstaton se duke marr parasysh që komisioni i pranimit nuk ka qenë i themeluar sipas kritereve ligjore, atëherë edhe procedura e vlerësimit të kandidatëve testit me shkrim dhe intervistës me gojë, është e pavlefshme, andaj duke marr parasysh këtë Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar në pretendimet të ankueses, e për rrjedhojë duke marr parasysh diapozitivin dhe arsyetimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës së Klinës, të ndërmarr veprimet për themelimin e Komisionit të Pranimit në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi me qëllim që procedura të zhvillohet nga faza e vlerësimit të testit me shkrim.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1801/2025

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses D.B;
- Kryetarit të Komunës së Klinae;
- Divizionit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinae; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.